

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8SH-1

Xh 78



POEZI

PERPARIM
XHIXHA

LULJA
QE RËRITET
MBI SHKEMB

8SH-1
Xh. 78

PËRPARIM XHIXHA

LULJA QË RRITET MBI SHKËMB

poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LIBRARIA SHKOLLE

LULLA QË RRITET
MBI SHKËMB

1976

Tirazhi 1500 kopje.

Format 70 x 100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1976

SHKËMBI NË TIRANË

LULJA RREDIT MBI SHKËMB . . .

Lulja rritet mbi shkëmb
Me të katër stinët-pranverë.

Vërtet lindi pak vështirë,
Vërtet rritet, duke u rrahur nga erërat,
Por mbetet lule mbi shkëmb.
Nuk është lule kënete,
Nuk është lule si hithër që djeg,
Aromën e saj e thith e gjithë bota,
Ajo merr vlagën që i duhet nga toka.

Krenarinë e vet ka lulja mbi shkëmb,
Sepse nuk është si kënga e ngrirë në buzët e të
vdekurit,
Sepse nuk është si lulet që dashnorët i dhurojnë
njëri-tjetrit.

Lulja rritet mbi shkëmb
Me të katër stinët-pranverë.

KU U RRI TA

Fisi im u gri nga plumbat
Në luftë me armiqtë dhe me njëri-tjetrin.
Kam ikur i vogël nga fshati im Backë,
I kam të pakta kujtimet!
Në cilën rrugë loza dhe çava kokën me gurë?
Shumë shtëpi, adresa dhe qytete ndërruam,
Duke biseduar me çekiçin, u rrita,
Duke më kapur për faqe shoferët,
Sepse ata e çuan babanë në Përmet,
Sepse ata e çuan larg në Shkodër,
Sepse ata e sollën jugut në Zvirinë,
Sepse ata e përcollën kantierëve me radhë
Dhe nëna pas tij,
Dhe unë pas nënës.

Atëherë kë të quaj vendlindje?
Jam rritur shtegtimeve
Dhe kam marrë dashurinë e çdo plisi,
të çdo guri;
Nga kjo tokë. . .

NËNAT DUKE PRITUR

Palosnin picetat siç ndanin ditët në orë,
Duke pritur të mbaronte lufta.

Mbetën gjithë ditën nëpër avëlmende duke endur.
Mbetën gjithë natën me shtiza në duar
Për një xhaketë a për një bluzë
Për djemtë e tyre në male.

Dhe thoshin me vete:
Na u kthefshin shëndoshë,
Na ardhshin petrita!

ÇDO PIKË TË GJAKUT TONË DO TA SHKRIJMË

Armët e të gjitha kalibrave do t'i përdorim,
Ashtu edhe gurët e maleve, sëpatat, hanxharët,
Do përdorim varetë e punës, cfurqet,
Për t'i kthyer të turpëruar, të mundur armiqtë
Ngado që të vijnë,
Sado që të jenë.
Dhe për të mbrojtur ditët tona të gëzuara, jetën,
Që çel e çel si trëndafil në dritaren e jetës sonë,
Çdo pikë të gjakut tonë do ta shkrijmë, domosdo,
Në zjarrin e luftës për ty, Atdhe.
Do ta shkrijmë, do ta bëjmë plumba
Për t'ia numëruar në ballë
cilitdo!

DO TË JETË E PATHYESHME KJO KËSHTJELLË

Do të jetë e pathyeshme kjo kështjellë,
Pavdeksia na përket të gjithëve,
Të gjithë neve, që e ndërtuam me gjakun,
Që e ndërtuam me djersën dhe nervat tona.

Do të jetë e pathyeshme kjo kështjellë,
Shpresë e të gjithëve që kemi qenë hyzmeqarë
Te mbretërit, feudalët, tregtarët...
Për ne që na është plasaritur buza nga mërzia,
Për ne të varfërit që nuk pamë një ditë të bardhë,
Për ne të shtypurit që u grimë në luftra.

Do të jetë e pathyeshme kjo kështjellë
Për ne që i lamë dasmat tona përgjysmë dhe ikëm
Nëpër llogore dhe istikame luftrash tragjike,
Ku lamë gjakun, fëmijët, shtëpitë, jetën, gjithçka,

Që priste të nesërmen si në ëndërr me diell.
Me më shumë kripë e me më shumë vaj për pushkët
Ikëm nëpër monopate malesh, duke kënduar këngët
Për vitet që do vinin dhe do sillnin lirinë.

Punonim gjithë ditën e lodheshim gjithë ditën.
Kështu vajti jeta jonë e shkurtër, e trishtë,
Brenda saj një fije lumturi nuk kish,
As nëpër këngët e as nëpër dasmat dhe gostitë.

Do të jetë e pathyeshme kjo kështjellë,
Ngritur mbi gërmadha e ngritur mbi eshtra,
Lyer me ngjyrat më të shndritshme të kohës
Me ngjyrën e gjakut të shokëve që ranë,
Me ngjyrën e luleve që u vyshkën nga zjarret
Me ngjyrën e grurit që u përvëlua në arë,
Me ngjyrën e syve të kaltër të fëmijëve,
Që ranë dëshmorë në moshën e tyre të njomë.

Do të jetë e pathyeshme kjo kështjellë
Me muret male të ngritur gjer në qiell,
I përkasim ne si ushtarë të përjetshëm asaj.
Mua edhe ty motër, ty vëlla, ne të gjithëve,
Pika e fundit e gjakut për të le të na pikojë
Në themelet gjer në fund të tokës,
Në themelet e patundura të saj.

KËNGA E KAZMËS DHE E PUSHKËS

Në buzët e popullit tim
Rri zgjuar kënga e kazmës dhe pushkës,
Siç rri ndezur ylli i mëngjesit
gjersa del dielli.

Në buzët e popullit tim
Rri zgjuar kënga e kazmës dhe pushkës,
Sepse nuk ngrysim ditët duke vrarë mendjen
Të xhirojmë filma, që mendjet të helmojmë,
Të presim minifundet e të përdredhim flokët.
Populli im thinjet në punë,
Populli im thinjet në shkollë,
Sepse kërkon gjithnjë e më fort
Me gjithë burrërinë e zërit të tij,
Të këndojë këngën e tij të njohur e të lashtë,
Këngën e kazmës dhe të pushkës.

Këngëtarët e kësaj kënge,
Bilbilat e kësaj kënge
Me zërin jehonë si të pushkës,
Ngrihen ia thonë 28 mijë dëshmorë
Me yjet e kuq komunistë në ballë,
Ku përvëlon puthja e hershme e nënave.

Le të çirret Marsheja dhe parlamentet,
Le t'i blejnë fronet presidentët me miliona dollarë,
Le t'i bien kryq e tërthor botës avionat-spiunë,
Le të bëhen ditë për ditë grushte shteti në të katër
anët e botës,

Ne dy milionë njerëz — shqiptarë
Ia themi këngës me zërin jehonë,
Këngës së kazmës dhe të pushkës.

Këndojeni dhe ju këngën e pushkës dhe kazmës,
Të gjithë popuj të botës.

PARTISË

Si erë pranverë kaq shpejt ikën vitet,
Nga bota e zezë e vuajtjeve u ndamë,
Borgjezët na qëllonin me thikë e me top,
Ua pamë hairin armiqve, ua pamë!

U bëmë mjeshtra në një mijë zanate,
U bëmë ne poetë, ministra, profesorë,
Armiqtë skutash turi e buzë mblodhën
E skutash mbetën vetëm si një sorrë.

Na the ti që të ishim të paepur,
Ndaj u sulëm në punërat më të rënda
E kur ndonjërit plaga s'i qe mbyllur
Ia thamë ne me këngë dhe me mëndra.

Na the ti që të bënim sytë katër,
Armiku rri e pret edhe përgjon.
Betimin ne e bëjmë si ushtarë,
Me turp do kthehet kush guxon.

SHTËPITË E REVOLUCIONIT

Dhe i vunë zjarrin shtëpisë së xha Aliut,
Sepse në shtëpinë e tij ishin shtypur trakte,
Sepse në dhomat e shtëpisë së tij ditën dhe natën
Gatuhej bukë dhe qepeshin xhaketa për partizanët,
Sepse në odën e vogël të tij stivë rrinin armët
Me çullet e dhirta të tij ishin mbështjellë këmbët
e ngrira të partizanëve.

Me sëpatën e tij të rëndë u ngjit në pyll xha Aliu,
Për të bërë qereste të re për një shtëpi të re.
Dhe nuk i kurdisi konaqet për rehatin e tij dhe të
plakës

Në mure la një kamare të vogël, të fshehtë
për traktet,
Në mure la një kamare tjetër
për armët,

Në mure la një kamare për letrat
që i vinin nga shtabet.
... Dhe përsëri i vunë zjarrin shtëpisë së xha Aliut,

Kur ende nuk kishte mbjellë hardhitë në oborr,
Kur ai ende oborrin nuk e kishte shtruar me plloça
Kur në odat e saj nuk ishte bërë asnjë dasmë,
asnjë gosti.

Dhe patën thënë qafirët e ardhur të Hitlerit
Do ta djegim dhe plakun Ali

si shtëpinë e tij,

Në male djemtë do t'ia kapim,

Në male djemtë do t'ia varim.

Po kënga nuk i mbeti në buzë xha Aliut,

As nënë Neslies,

e mira Naslie!

Dhe plumbat nuk mbetën në gojë të pushkëve

Me sëpatën e rëndë të tij betejave po sulej. . .

Të shtënat e fundit të luftës dëgjoheshin.

Me sëpatën e tij të rëndë u ngjit në mal,

Për të bërë qereste të re për një shtëpi të re,

Dhe thirri mjeshtrin më të mirë gurskalitës

Me daltë dhe çekiç,

Për të bërë në ballë të oxhakut të gurtë

Yllin e kuq komunist.

Malind 1973

KOMUNISTËVE MOSHATARË

Sa shpejt e ndjen toka hapin tuaj,
Siç ndjen zemra e dashuruar fjalët.
Këtë vjeshtë të ngarkuar me rreshje të shumta,
Ju patët shumë punë,
vëllezër moshatarë.

Që kokrrat e misrit mos mbeteshin në arë,
Natën ndezët fenerët dhe nxituar fushës,
Se kokrra e misrit është pikë e djersës suaj,
Se një bohçe pambuku është një bluzë e bukur.
Prandaj u ngarkuat vetë,
Pa pritur të vinin zetorët, qerret, kuajt,
Ia morën frymën,
thoni,
pellgjet me ujë!

Të nesërmen gjithë ditën,
Edhe nën dritën e hënës,

Edhe nën dritën e fenerit,
Me thonj dhe bela rrugë i hapët ujit,
Të rrjedhë,
të shkojë,
Gjer në dhëmbje e dashkeni tokën,
Dhe tokës i dhimbseni ju,
Prandaj ju thotë me zënë e saj të ngrohtë:
— Mos vishni çizmet e llastikut, djema,
Pa veshur në këmbë çorape të leshta!... —

Gjer në dhëmbje e dashkeni tokën,
Dhe toka përgjërohet për ju dhe thotë:
— Ju kam bujqër të mirë!
Me zërin e saj të dashur e të ngrohtë!

SHOKU

Ju, shokë, mbajeni grushtin lart,
Të mbërthyer te tëmthat!

Na vdiq dje minatori më i vjetër, minatori Nazo.
Dy sytë e tij shikonin qartë të ardhmen
Dhe na thoshte:

Drejt saj po marshojmë!


Drejt kësaj rruge, na dolën thinja,
Drejt kësaj u bëmë si hekuri të fortë,
Drejt kësaj rruge lule na çeli rinia!

Mos dëshpërohemi ne për një shok.
Që në krahët e vdekjes na ra?

Mos qajmë ne për një shok, që iku për jetë?
Mos këndojmë ne për një hero të vërtetë?
(Pa çka se mund të na dridhet zëri nga dhëmbja,)
Po atëherë për kë të qajmë,
Po atëherë për kë të këndojmë?

Ju shokë, mbajeni grushtin lart,
Të mbërthyer te tëmthat!

17



14252

TEK MENDOJNË NJERËZIT PËR JETËN

Në majën më të lartë të malit të së ardhshmes
Çdo njeri kërkon të ngjitet më shpejt,

më i sigurtë,
më i ndershëm,

Duke u parë herë pas here në pasqyrën e viteve,
Që ikin nxitimthi.

Si ortiqe viganë në ndërgjegjen e njerëzve lëvizin
ngjarjet

Me bukurinë e tyre njerëzore brenda,

Me ashpërsinë e tyre njerëzore brenda.

Dhe miliona njerëz në pika të ndryshme të globit,

Nën një hije lisi,

Në një udhëtim të largët me avion,

A në shtratin e tyre të gjumit,

A në bankat e shkollës, a përpara vitrinave, urave,
deteve e luleve

Grinë e mendojnë për jetën:

E bukur qënka,

Po bukurinë shpesh duart gjakatare të tiranëve të
popujve ia kanë përlyer.

Ngjitemi. . .

Në majën më të lartë të së ardhshmes,

Do të ngjitemi të gjithë ne, komunistët,

Dhe ata që punojnë përkrah nesh,

Dhe ata që në gjurmët tona ecin.

Dikush nga ne mund të bjerë,

Ky fat dhe mua mund të më takojë;

Atëherë qoftë dhe një ditë do të jem në këgët e
popullit,

Si një luftëtar i ri, i vendosur,

A nuk është edhe ky një mendim për jetën

Me bukurinë e tij njerëzore brenda?

1939

Deti sikur e ndjeu pushtimin që po vinte,
Ashtu siç ndjejnë prishjen e kohës,
Ata që nga reumatizma vuajnë,
Ashtu siç lajmërojnë ardhjen e vjeshtës
Me ikjen e tyre të nxituar lejlekët...

Të rritur buzë detit dhe armëve
Burrat i kuptuan fjalët e trishta të valëve,
Kokrrat e misrit i zbrazën nga thasët e leshtë
Dhe rendën buzë detit i mbushën me rërë
Ngritën barrikada dhe morën dyfegjet me gjalmë.

Prapa tyre

këngët,

Prapa tyre

malet,

Populli në këmbë

barrikadë.

LUGA E TË BURGOSURVE

*E keni parë këtë lugë në muze-
umin e Luftës Nacionalçlirimtare?*

Çdo send mund të bëhet një armë
Për të fituar e drejta e njeriut;
Ashtu siç u bë një lugë
Shpresa e shpëtimit për njëzet e gjashtë gra
Të gjitha nëna...

i kishin fëmijët në gji.

Iknin ditët si zogj shtegtarë,
Duke ngritur nga një fole për ëndrrat e së
ardhshmes,
Kurse ato-njëzet e gjashtë gra të burgosura
Kishin në dorë vetëm një lugë
Dhe atë kishin dhe shpresë dhe armë.

Muret e burgut çaheshin nga zërat e tyre,
Binte suvaja si gjethet nga era e tetorit,
Ashtu siç do binin në botë nga fronti perandorët.

Me atë lugë
Njëzet e gjashtë gra të burgosura
Prisnin të nesërmen të fitonin,
Të shikonin edhe një herë diellin,
Të dinin në cilin muaj jetonin,
T'u jepnin të paktën edhe një herë gji fëmijëve,
Në ishin gjallë kërthinjët. . .

Ato njëzet e gjashtë gra të burgosura,
Që kishin vetëm një lugë si shpresë,
Që kishin vetëm një lugë si armë
Filluan të shkruanin mbi mure gërmat e para,
Këngët më të bukura që i kemi kënduar lirisë
«VF — LP»

Gërvish çdo ditë,
Gërvish çdo ditë nga pak
Një të çarë drejt diellit kërkonin ato.
Gërvish çdo çast,

Tani gjumë nuk ka
Liria, fëmijët dhe burrat janë përtej
Mureve të nxira, të gërvishura të burgut.
Liria, malet, shokët janë shumë larg
Lakut të litarit që rri varur në oborrin e burgut.
Gërvish më shpejt t'i arrijmë,
Gërvish më shpejt çdo çast!

Mos e ndërprisni këngën e lirisë, shoqe,
Rruga e madhe drejt lirisë u hap
Me lugë, me thonj!
Dhe ikën drejt maleve dhe shokëve
E fundit e mori lugën me vete në gji
Një copë metal i ngarkuar plot me poezi.

N Ë N A T T O N A

1.

Nënat tona,
Me supe të vrarë nga rripi i pushkës,
Kur qeshni ju
Gjithë bota duhet të qeshë e çiltër.

Shtëllunga resh,
Si shtëllunga leshi të bardhë mbi furkat tuaja,
Tirrni dhe tirrni, duke ia thënë këngës,
Dhe rrugë merrni dhe nga rruga balli u rri i djersirë,
Në rrudhat tuaja gjithmonë ka pasur djersë të florinjtë
Dhe kenë shkuar në kroje e kenë freskuar faqet,
Kenë ngarë qetë dhe vetë kenë hedhur farë,
Për të rritur fëmijë të shëndetshëm dhe trima.
Dhe djersa juaj ka rënë selishte më selishte,
Dhe djersa juaj ka rënë në çdo copë shajaku,
Dhe djersa juaj ka rënë në varfërinë tuaj,

Po ju gjithmonë bujare mbetët
Mikun dhe udhëtarin
E prisni dhe e përcillni si bir të vetëm.

2.

Që kur u lindëm
Dhe gjersa u bëmë burra
Në krahët tuaj mbetëm. . .

3.

Nënat tona me zemra të zhuritura nga lufta.
Në buzët tuaja të rreshkura nga hallet
Pamë rrugën tonë të gjatë.
Në gjirin tuaj janë fshehur çorape të leshta,
Për këmbët e ngrira të bijve partizanë,
Janë fshehur fotografitë e bijve tuaj që ranë.

Ne pamë në sytë tuaj dasmat tona të ardhshme,
Sepse në gjirin tuaj rrinin traktet e PKS, H,
Sepse në buzët tuaja, si mali i Tomorit,
Rrinte emri i Enver Hoxhës.
Dhe ju, duke pritur të ardhshmen,
Gdhinit netët duke endur shajak për xhamadane,
Gdhinit netët duke qepur fanellat e bëra copë-copë.

Ne natën vinim,
Ne natën iknim,
Me vete na jepnit nga një gjerdan fishekë,
Me vete na jepnit nga një gjerdan me këngë,
Dhe linim prapa shtëpitë e rrënuara nga lufta.
Ju na përcillnit gjer larg
Dhe nisnit të nesërmen
Të kullonit djathë në napë.

4.

Bijtë tuaj u bënë poetë,
Bijtë tuaj u bënë ushtarë
Ju prapë me malet në zemër,
Por malet syrin mbajnë në shënjestër
Dhe ne gabojmë kur themi:
paçi pleqëri të bardhë!
Ju në hallet tona merrni pjesë me djersë,
Ju në gazet tona merrni pjesë me këngë.
Nënat tona,
Kokat me çembere,
Mbi supe një pushkë,
Ju na tundët djepet,
Ne po tundim malet

NËNA E POETIT

Djali humbi në biseda me njerëzit,
Nusja e tij vjen natën në shtëpi
Mbeti dhe ajo me njerëzit e këshillit,
Sikur e madhe të ishte në qeveri.

Mbetet vetëm dhe librat merr në duar,
I shfleton ato fletë më fletë,
«Pa t'i shikojë nëna çfarë ke shkruar,
A ka në to dhe këngë për lëmenjtë?»

O bir, a ke shkruar në libra,
Kur qaje atëherë në odë për një defter,
Kur unë e ngrata me këto dy duar
Një herë në javë sitja një grusht miell?

Po vallë selishta a të është kujtuar,
Aty yt atë nga plumbat u nda në mes.
«Mos u mposhtni, vëllezër, pa fituar,
Dikujt në luftë iu dashka që të vdes!»

S'di pa mëri të madhe do të mbaja
Dhe librat do t'i grisja çika-çikë,
Sikur këtu, biro, mos të kesh shkruar,
Si çdo pëllëmbë mbrojtëm me belxhik.

B A B A I

Kapotën tënde ushtarake dhe dekoratat
Nëna i shikon sa herë që e pushton malli,
Dhe grushti i luftës gjëmon nëpër dhomë
E zmadhohet portreti në mur nga kujtimet.
Sytë e tu:

 sy komandantësh të rreptë,
Presin dhe përcjellin shumë luftëtarë...

Etërit e brezit tim mbetën nëpër luftra,
Po nuk i mposhten plagëtë
Dhe në beteja të reja qëndrojnë në ballë.
Dhe ne, bijtë e tyre, ikim dhe vijmë nga malet,
Sjellim qytetve erën e barutit dhe të eshkës
Dhe ngjitim maleve gjerdanët me drita për nusët.
Sjellim qyteteve shkëmbinj, ku gdhendim përmen-
dore,
Ngjitim maleve zërin e luftës të njeriut me hekurin.
Në këtë rrugë të gjatë e të vështirë
Rrallëkush nga ne tha:

 u lodhëm!

Shpesh dhe balli im rri i djersirë.
Sa shumë i gëzohen djersës sime druvarët,
Sa shumë i gëzohen djersës sime shoferët!
Dhe më pyesin:

— I kujt je ti, mor djalë?

Si t'u përgjigjem,
Baba?

-- Jam i revolucionit. . .

U D H A E M B A R Ë

Akoma disa nga ata
Nuk kanë vajtur në kinkalери
Të blejnë takëmin e rrojes.
Akoma disa nga ata
Nuk janë ulur këmbëkryq me burrat rreth sofrës,
T'ia thonë këngës dhe të ngrenë me fund një
dolli.

Ata ditën djersijnë në punë,
Natën flenë vonë.
Përkulur, si dega e ngarkuar, mbi fjalore
Fantazia e tyre e zbret hënën në dhomë,
Ngrenë dhe prishin projekte makinash,
Të mëdha... të vogla...
Fshehtas me vete zihen me shpiksat,
Sot nuk guxojnë.
Nesër!

Nuk janë as dy, as pesë,
Janë një brez i tërë që po rritet.
Ata fjalës së shkencës sonë do t'i thonë:
Udha e mbarë të qoftë nëpër vite!...

NATA ENDET NË HAPËSIRËN E PAFUND

Nata endet në hapësirën e pafund
Endet dhe nuk di ku të trokasë,
Kokën mbështet në jastëkun e luftës.
Endet nata nëpër botë dhe kërkon strehë
Dhe futet në xhepat e majme të diplomatëve
Dhe bën një sy gjumë sa të marrë pak fuqi.
Po në net të tilla gjumë nuk kam kurrë,
Rreth sofrave netët i gdhij me këngë,
Pranë pushkës netët i gdhij me alarme
Dhe pres të lindë e nesërmja më e bukur

DUART E KOMUNISTIT

K. Yllit

Dora tënde plot damarë dhe pak e djersirë,
Si toka e butë me brazda e lagur nga vesa,
Nuk shkon më mbi supet e shokëve dhe fqinjëve,
Nuk u rreh më shpatullat bashkëfshatarëve.
Nuk këput qoftë dhe një verigë rrushi në pjergullat
e nënë Neslies
Tek ajo lutet dhe lutet...

Flokët e thinjura, të bardha si qeleshja e Tomorit,
Nuk i shprish më kjo erë e Qafës së Martës,
As sytë, as buzët, as zëri, as hapat
Nuk janë më për shikime drejt viteve,
Nuk janë më për çmallje, këngë dhe rrugë...

Dy duart e tua,
Duart e komunistit
Prej vitesh janë të lidhura
Me duart e të gjithëve.....

FRAN NDUE IVANAJT

Hero i Popullit

Fëmijët ikën nga dritarja, ku prisnin të ktheheshe,
Dhe lotët iu mbetën në sy,
Në buzët e njoma u mbeti fjala:
baba!

Se deti me rropamë përplasi dallgët në brigje,
Dallgët na goditën gjoksin tonë të fortë,
Kutitë e duhanit hapën pleqtë e mirë,
Ndjenë therrje e dhembje në koskë
Siç ndjejnë kur koha priset e bën shqotë.

Deti pak dallgë kish e ti ashtu e doje,
Psherëtinë nënat me dhembje atë ditë
Dhe pyetën: «Rrugën kush ia preu djalit,
Me predhë e plumb mbi të cili ka qitë?»

Armiku erdhi në detin tonë të pastër,
Kur ti, vëlla, me shokët ndiqje gjahun
Dhe zjarrit batore i vure gjoksin,
Në krah të pritëm si Mujo Ulqinakun.

DUA QË ÇDO DITË TË JETË

Nuk kam qetësi atë natë,
Kur lodhja nga puna nuk më ul qerpikët,
Po nuk e ndjeva lodhjen e punës
Në muskuj, nerva dhe në eshtra.
Vetveten qortoj i pagjumë,
i vrarë shpirtërisht,
Sepse pak gëzim dhe lumturi i kam marrë
Botës së madhe të punës dhe të djersës
Unë si komunist.

Nuk kam qetësi atë natë,
Kur lodhja nga puna nuk më ul qerpikët,
Sepse nuk u përkas atyre njerëzve që lumturohen,
Kur hipin peshoreve të qytetit
Dhe thonë me vete me kënaqësi:
— Këtë muaj kam shtuar dy kile,
bukuri!

Sepse nuk u përkas atyre njerëzve që trishtohen,
Kur hipin peshoreve të qytetit
Dhe ankohen me dhembje tepër të thellë:
— Bobo, po tretëm këtë verë!

Nuk ndjej qetësi atë natë,
Kur lodhja e punës nuk më rëndon mbi supe,
Kur lodhja e punës nuk më peshohet në duar,
Kur lodhja e punës nuk përkund si fëmijë
Brenda gëzimeve të mëdha të ditëve.

Sepse nuk u përkas atyre njerëzve
Që lumturohen lehtë,
Që trishtohen lehtë,
Që lodhen gjithashtu shpejt.
Dua që çdo ditë të jetë
Betejë e fituar dyfish!

PRESIM TË NDIZET FURRNALTA

Çdo ditë presim. . .

Presim gëzime të reja të vijnë;

Pret gjyshja të përkundë nipçen në prehër,

Presin të rinjtë e dashuruar dasmën,

Presin nëntëmbëdhjetëvjeçarët të nisen ushtarë,

Secili ka gëzimin e vet dhe ëndrrat,

Çdo ditë presim.

Pret fëmija t'i kthehet nëna a baba nga shërbimi,

Vullnetarët presin inaugurimin e hekurudhës,

Presin të tjerë të vijë vera, të piqet rrushi,

Këtë vit shoku im pret të korra të mbara,

Njerëzit presin gëzimet e tyre,

Gëzime të lidhura fort me dashurinë dhe punën.

Secili nga ne pret gëzimin e vet.

Çdo ditë presim

Si një gëzim i të gjithëve presim të ndizet

Furnalta e parë shqiptare.

KËNGË PËR NJERIUN

Fëshfërijnë gjethet nga era e lehtë në pyje,
Bilbili këngës seç ia merr,
Ta ka ënda mbi lëndinë të shtrihesh,
Të lash duart me vesë!

Tunden majat e lisave nga era
Dhe dridhet zëri i bilbilit këngëtar,
Te kënga veshi dhe zemra më rrijnë,
Po s'është ai i vetmi këngëtar.

Këngëtar jam dhe vetë,
Po unë këndoj për njerinë,
Për atë që bukur dhe thjesht në jetë
Krijon më shumë se njëqind poetë.

Z E M Ë R I M I

Zemërimin tim nuk e kyç në mendje, në zemër,
Si portën time mëngjes për mëngjes,
Bashkë me hapat e mia dhe gëzimet e shokëve,
Zemërimin tim i them:

udha e mbarë të qoftë!

Se nuk më pëlqen të shoh fqinjin buzëvarur,
Duke sharë rëndë nëpër dhëmbë një vagabond,
Se nuk dua të shoh vajzën e komunistit Lace,
Të bëjë dashuri me një vagabond.

Zemërimin tim i them:

udha e mbarë të qoftë!

Se nuk më pëlqen të shoh djemka të lëpijnë akulllore,
Ulur gjithë ditën hijeve, që nën hije rrojnë,
Se nuk dua që dekoratat e komunistit Lace
T'i zerë në gojë e të mburret një vagabond.

Zemërimi im është shpirti im i ndezur,
Ndaj s'bie kurrë në kurthe lajkash, provokimesh,
Ndaj di ta ruaj të pastër bukurinë e fjalës dhe të veprës,
Ndaj di t'i them kujtdo pa frikë e pa smirë:
Sus!

Se je futur në rrugë jo të mirë
Dhe eja me mua të rendim skelave ku ngrehim shkollat,
Të shkojmë të bashkojmë duart me duart e punëtorëve
Plot llaç, pluhur e djersë,
Që sytë nga krenaria e punës më pa bujë të shkëlqejnë!

A T E N T A T O R Ë T

Kjo fjalë ka krismën e vet
Tek vjen lidhur ngushtë me ditët,
Tek vjen lidhur ngushtë me armët,
Perandorinë e qëlluar në ballë!

Kështu mbeti kjo fjalë;
Përpara emrit tënd, Vasil Laçi,
Përpara emrit tënd, Lym Keta,
Si një krismë vetëtime revolveri,
Si krisma e parë e një lufte
Që i ndezi gjakun popullit!

TË GJITHË JU QË JENI BABALLARË

Të gjithë ju që jeni baballarë
Mos i shkelni syrin shoku-shokut,
Tek më shihni zjarr se si kam marrë
Nga gazi i rrallë që më lindi vajzë.

Kur të bëhesh vetë baba,
Më thoshte nëna ime e mirë,
Ke për ta ndjerë më thellë dashurinë
Se sa i dhemshur është një fëmijë.

Ke pasur të drejtë ti, nënë,
Ta shohësh zemrën si më rreh,
Po ty, vallë, kështu të pati rrahur
Kur linda unë në odën përdhe?

V J E S H T A

Tani ne shohim nga çasti në çast
Prishjen e tuneleve të gjelbërta të pemëve.

Vjeshta ikën dhe ne mbajmë diçka prej saj,
Ngjyrën e kuqe të mollëve.

Vjeshta ikën dhe ne i themi «udha e mbarë»,
Duke mbajtur si kujtim të stinës një kokërr limoni.

Ajo ikën dhe tunden gjethet tek bien,
Siç tunden duart nga dritaret e një avioni.

Mirupafshim, e shkarkuara vjeshtë,
Mbi tokë na lë copëra ylberi!

L I R I K Ë

Motiv popullor

Vajzat shamibardha,
Vjelëset e pambukut,
Kthehen që nga fusha
Me këngë në gojë.
— Ju këndoftë zemra! —
Ia presin dy djema,
Që pas po iu shkojnë. —
Moj sorkadhja jonë!

Vajzat ballëndritura,
Me llërë përveshur,
Kapelat prej kashte
Thellë kokës ngjeshur.
Kthehen që nga fusha
Me këngë në gojë
— Kush na mbeti prapa?
Ah, sorkadhja jonë!

PRANVERA QË NUK HARROHET

Qerpikët e akullt të çatave në dimër
Mua nuk më trembin,
Ato ma ngrohin zemrën si kujtimet.
Dy sytë e tu të bukur më shfaqen tani,
Ngrohtësia e tyre më afron pranverën.
Fillon rënia e bukur e pikave,
Unë duart zgjat
Me gishtat që dridhen nga malli.
Tani është pranverë,
Unë duart zgjat
Me grushtin tim mbledh pikat që bien.
Më duket sikur pres lotët e gëzimit tënd,
e dashur,
Dhe me to sot vadit një trëndafil,
Që kur të çelë do ta sjell ty.
Se unë e di që mahnitësh pas luleve,
Prandaj e do sa mua pranverën.
Është koha kur lozin shumë fëmijët,
Po Ejana jonë është ende e vogël,
Sa një lule, sa një trëndafil.

LERMANI VAJZËN TË FLERË

Shtëpia ime buzë detit e bardhë
E përkëdhel puhizë e lehtë në verë,
Vërtiku i dimrit ashpër seç e rreh.

Unë jam në dhomë vetëm me vajzën
Me nina-nana heq dhe ajo s'fle.
Prandaj më lehtë përplasuni ju dallgë,
Ti erë kanatet të qeta s'po i le.

Të bjerë në gjumë kjo vajzë e vogël,
Ti erë e marrë kështu mos ulëri,
Se kur të rritet do të bëjë ballë,
Po sot të lutet:

«Lemë që të fle».

KU LUHEN SOT TRAGJEDITË?

Ti je një vajzë e re që ecën kudo në botë,
Duke pirë helmin e trishtimit të rinisë sate.

Ecën duke kërkuar diçka të re nga koha,
Diçka të fuqishme që mund të të çlirojë
Zemrën tënde të rrahë si e imja...

Shoh qartë rrugën tënde, moj motër,
Si të mashtrojnë me tundjet e verbra të rublës,
Me zhurmimin e gotave të uiskit dhe të xhazit,
Si të shtyjnë e të mbyllin në kafazin — vilë,
Si të shtyjnë e të mbyllin në kafazin — makinë,
Si të afrojnë kamera, dollarë,
Që pleqërisë së botës t'i shesësh dashurinë.

Çdo ditë dëgjoj zërin tuaj, nëna dhe motra të botës
Dridhen antenat tek kapin fjalët lëshuar në eter,
Fjalët tuaja që rrökullisen në tragjedinë tuaj,
Që luhet përpara kasafortave — giotinë,
Që luhet në amfiteatrin e dramave të njerëzve,
Kur fjalët e ditëve të së ardhshmes trondisin botën
Me rrënjë të ngulura në faqet e «Kapitalit» të Marksit.

Ndaj sot më duhet ta ngre më lart zërin tim
Si bir i një vendi vërtet të lirë të globit,
Ku nënat dhe motrat i kam
dashuri të shenjtë,
Që ëndrrat tuaja mos bien nga zemra juaj.
Siç bie sot hiri,
Kur pinë puro Havane pronarët.

FËMIJËT E BOTËS KAPITALISTE

Tani është mesnatë,
Fëmijët e botës flenë,
Në ëndrrat e tyre zënë e shfaqen librat
Në gjuhët më të ndryshme shkruar,
Në ëndrrat e tyre zënë e shfaqen policët
Dhe kithin fëmijët në gjumë:
— Babin e morën me vete policët,
Mami, na e vranë babin sherifët!

Mundohen nënat të qetësojnë fëmijët
Me shpirtin e tyre të copëtuar,
Dhe lotët e tyre si djersa e tyre
Me kambialet, çeqet nëpër banka përzihen
Me dosjet e diplomatëve që bredhin lart-poshtë
Nga një kontinent te tjetri,
Nga Shtëpia e Bardhë tek uzina avionesh,
Nga Kremlini tek aeroplanmbajtëset, tanket.
Nga Shtëpia e Bardhë në uzina avionesh
Duke shkëlur mbi gjumin e frikshëm të fëmijëve:
— Babin e morën me vete policët,
Mami, e vranë babain sherifët!

Fëmijët e botës nuk flenë
E ku të flenë?
Fëmijët e botës enden nëpër rrugë
Duke lustruar këpucët e ushtarëve, policëve,
Këpucët që i ranë prapa kokës babait,
Kur ai ishte përpara torturave.
Fëmijët e botës nuk flenë.
E ç'të flenë?
Sa bota i kanë hallet të mëdha!

KUR ISHIM NE STUDENTË

Qyteti ynë ka vetëm banorë të rinj
Dhe unë thosha ky është qyteti i dashurisë,
Vetëm për të mos thënë troç «Të dua».
Qyteti ynë nuk ka asnjë varrezë
Dhe unë thosha ky është qyteti i së ardhshmes,
Vetëm për të mos thënë troç «Nuk do të ndihemi
kurrë».

Qyteti ynë ka si çdo qytet gazetën e vet
Dhe unë thosha ky është vendi i takimit të parë
Vetëm për të mos thënë troç

«E lexove poezinë që kisha shkruar për ty?»

NE TË DY

Diçka kemi në vetvete nga të tjerët.
Ata kanë në zemër, mendje a ëndrra diçka tjetër
nga ne të dy.

Nënat kanë dashurinë për ne,
Ne kemi dashurinë dhe mallin për to.
I përkasim gjithçkaje që ka rrënjët në gëzimet e
popullit,

Diçka nga kryengritjet, grevat, dasmat a lëmenjtë,
Diçka kemi në vetvete nga të tjerët.
Vargje poemash, përrallash, tregimet e një këpucari fqinjë,
Kemi krenarinë e etërve, diçka nga zemërimi dhe
përkëdhelitë e fëmijëve.

Ne të dy u përkasim këngëve që këndohen për të
ardhshmen

Ngritur nga mijëra qytetarë, ushtarë dhe nëna trime.
I përkasim shtegtimit të montatorëve dhe zogjve,
Punës dhe cicërimit të tyre të gjatë.

TI ZBRITE DUKE RENDUR

Ti zbrite duke rendur nëpër shkallë
Një çantë të bukur mbaje nën sqetull,
Nuk ike ti me shoqet drejt shtëpisë,
Nesër ai të pret e gjatë do të presë.

Kë kërkon që kokën prapa ktheve,
Nxirre letrën se nuk të sheh njeri,
Mos u druaj, le të thonë të tjerët,
E urtë vajzë ishte, po ra në dashuri.

Çantën hape — plot drita ka në rrugë,
Tre herë lexoje letrën me një frymë.
Ai pret, pret për t'u takuar nesër,
Më gjatë, besoj, nuk të kishte shkruar?

K U D O J E T I

Zhurma e hapave është e ëmbël,
Njëqind herë kam kaluar në këto ugarë,
Dashuria më pëshpërit disa fjalë.
Ajo pret të shkosh, mos harro,
Pret dhe numëron sekondat si ëndrra,
Kudo je ti.

Hëna dhe unë gjithmonë jemi zgjuar
Si nëna jote si nëna ime e mirë,
Kur fshihesh ti të gjej në sytë e nënës,
Kur fshihesh ti të gjej në zemrën e nënës,
Kudo je ti.

Reklamat flasin, qyteti hesht,
Nata është imja si vendtakim sekret,
Neonet si vetulla të arta trotuaresh
Farfurijnë si ëndrra jote, e dashur,
Ndërsa ti mbledh gëzimet e rrugëve
Me të dy duart,
Kudo je ti.

PASQYRA E LËNDËS

Lulja rritet mbi shkëmb	3
Ku u rrita	4
Nënat duke pritur	5
Hekurin e gjakut tonë do ta shkrijmë	6
Do të jetë e pathyeshme kjo kështjellë	7
Kënga e kazmës dhe pushkës	9
Partisë	11
Shtëpitë e revoiuacionit	12
Komunistëve moshatarë	14
Shoku	16
Tek mendojnë njerëzit për jetën	18
1939	20
Luga e të burgosurave	21
Nënat tona	24
Nëna e poetit	27
Babai	29
Udha e mbarë	31
Nata endet në hapësirën e pafund	32
Duart e komunistit	33
Fran Ndue Ivanajt	34
Dua që çdo ditë të jetë	53
Presim të ndizet furnalta	37
Këngë për njeriun	38
Zemërimi	39

Atentatorët	41
Të gjithë ju që jeni baballarë	42
Vjeshta	43
Lirikë	44
Pranvera që nuk harrohet	45
Lermani vajzën të flerë	46
Ku luhen sot tragjeditë	47
Fëmijët e botës kapitaliste	49
Kur ishim ne studentë	51
Ne të dy	52
Ti zbritë duke rendur	53
Kudo je ti	54